



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE TË BRENDSHME
DREJTORIA E BUXHETIT DHE MENAXHIMIT FINANCIAR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2018

Lënda: Dërgohen raportet e monitorimit për vitin 2017

MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË


TIRANË

Në zbatim të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit Nr.130/2016 “Për buxhetin e vitit 2017”, Udhëzimit plotësues Nr.8, datë 13.01.2017 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2017”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave, Nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, pika 256, Udhëzimit nr.22 dt 17.11.2016 “Për procedurat standarte të Monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore” ju dërgojmë raportet e monitorimit të buxhetit për vitin 2017, duke analizuar performancën financiare dhe realizimin e produkteve dhe objektivave, sipas programeve.


Ministria e Drejtësisë ka administruar dhe menaxhuar fondet buxhetore për tetë programe konkretisht:

- 1. Planifikim, Menaxhim dhe Administrim*
- 2. Qendra e Botimeve Zyrtare*
- 3. Instituti i Mjekësisë Ligjore*
- 4. Sistemi i Burgjeve*
- 5. Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor*
- 6. Komiteti Shqiptar i Birësimit*
- 7. Agjencia e Trajmit të Pronave dhe ALUIZNI*
- 8. Shërbimi i Provës*

Buxheti i Ministrisë së Drejtësisë sipas Institucioneve



Realizimi i Buxhetit sipas dy Zërave Kryesorë të Shpenzimeve në mijëra lekë



Në total për Ministrinë e Drejtësisë shpenzimet e personelit janë realizuar 97.57%, shpenzimet operative 86.74 % kurse shpenzimet kapitale 77.33%. Të gjithë strukturat vartëse të Ministrisë së Drejtësisë, kanë punuar për të plotësuar objektivat e parashikuara në programet e tyre si edhe për të realizuar produktet e përfituara, duke përdorur me efikasitet dhe efektivitet fondet buxhetore të akorduara për çdo program dhe për çdo zë shpenzimesh.

Një analizë më të hollësishme të realizimit të shpenzimeve dhe produkteve, për 8 programet e Ministrisë së Drejtësisë, e sjellim më poshtë:

Monitorimi i Shpenzimeve dhe Produkteve sipas programeve.

1. Programi “Planifikim, Menaxhim, Administrim”.


Ky program përfshin 5 institucione:

1. Aparatin e Ministrisë
2. Avokaturën e Shtetit
3. Komisionin Shtetëror për Ndihmën Juridike
4. Agjensinë për Mbikqyrjen e Falimentit
5. Arkiva Shtetërore e Sistemit Gjyqësor

Realizimi për këtë program, duke e krahasuar me planifikimin e periudhës, sipas zërave kryesorë, rezulton si më poshtë:

• Shpenzimet e personelit	87.34 %
• Shpenzimet e tjera operative	78.51 %
• Shpenzimet kapitale	61.87 %
Gjithsej	73.16 %

Grafiku i paraqitur në mijë lekë



Për kryerjen e veprimtarisë kryesore dhe përmbushjen e objektivave të përcaktuara, për vitin 2017 Programi Planifikim, Menaxhim, Administrim, ka parashikuar këto produkte “Menaxhimi i Përgjithshëm i Ministrisë” është realizuar plotësisht, “Akte ligjore e nënligjore të hartuara” janë planifikuar 42 akte dhe janë realizuar 31 akte ligjore dhe nënligjore. “Inspektime në Prokurori, inspektime në Gjyqësor, Administrativ dhe në Pronësi”, nga 20 inspektime të parashikuara, u realizuan 10 inspektime, vlen për tu theksuar për inspektimet në institucionet vartëse dhe në profesionet e lira, se janë kryer inspektime me shtrirje në zyra përmbartimore, noterie dhe institucionet e varësisë.

Produkti “Asistencë Juridike Institucione Shtetërore dhe Enteve Publike nëpërmjet këshillimit dhe përfaqësimit në gjykatat Ndërkombëtare” është realizuar në terma sasiorë, nga 12.000 raste të parashikuara për përfaqësim të avokatëve të shtetit në çështjet gjyqësore janë realizuar 13.496 , si edhe është dhënë “asistencë juridike dhe këshillim” nga avokatët e shtetit.

“Ndihmë juridike për individët përfitues” është realizuar në terma sasiorë. Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike ka parashikuar ofrimin e ndihmës juridike, këshillimit dhe mbrojtjes në proceset penale për 700 raste për vitin 2017 dhe janë realizuar 508 raste.

Për Agjensinë e Mbikqyrjes së Falimentit janë parashikuar dy produkte “Licensimi i Administratorëve të Falimentit” produkt ky që nuk është realizuar pasi nuk është lincensuar asnjë administrator për shkak të mungesës së drejtorit të institucionit. Produkti i dytë “Mbikëqyrja e Administratorëve të Falimentit” janë planifikuar 30 mbikqyrje të cilat janë realizuar 100%.

Shpenzimet kapitale janë realizuar 62% kjo për shkak se: mirëmbajtjet e sistemeve në fund të vitit 2017 janë paguar nga shpenzimet operative dhe jo sipas planifikimit të fillimit të vitit në shpenzime kapitale.

Nga ministria e financave janë akorduar me Aktin Normativ Nr.3 fonde buxhetore në vlerën 191 milion 616 mije lekë nga keto:

Fondi prej 90 milionë lekë për rikonstruksion të Godinës së Kolegjit të Apelimit

Fondi prej 60 milionë lekë per blerje pajisje zyre për Kolegjin e Apelimit.

Fondi prej 47.6 milionë lekë për rikonstruksion të zyrave të Avokaturës së Shtetit


Nga këto është realizuar projekti blerje pajisje zyre dhe një pjesë e fondit (shtesë kontrate) të rikonstruksionit të Zyrave të Avokaturës së Shtetit. Për projektin e rikonstruksionit të Kolegjit të Apelimit është lidhur kontrata me subjektin fitues por për efekt të pamjaftueshmërisë së kohës nuk është paguar kontrata e lidhur pasi nuk kishin filluar punimet. Për projektin e mbikqyrjes elektronike është realizuar plotësisht fondi i akorduar në fillim të vitit, Sistemi ALBIS është realizuar, gjithashtu Regjistri Noterial dhe Sistemi ICMIS janë realizuar sipas kontratave të lidhura.

2. Programi “Qendra e Botimeve Zyrtare”

Realizimi i shpenzimeve të vitin 2017 për këtë program, i krahasuar me planin e periudhës, është në masën **78 %**, ose sipas zërave kryesorë:

- Shpenzimet e personelit 98.7 %
- Shpenzimet e tjera operative 49.45%

Gjithsej 78%



Siç shihet, realizimi i shpenzimeve të programit është në shifra mesatare, si në shpenzimet e personelit dhe në shpenzimet operative.

Për vitin 2017 janë parashikuar 4 produkte të programit, nga të cilët dy janë tejkaluar, një është realizuar plotësisht dhe tjetri është realizuar 94%, “Publikimi i fletores zyrtare”, “Botime Kode dhe Përmbledhëse Legjislacioni”, “Botimi i Buletinit të Njoftimeve Zyrtare”, dhe “Publikimi në Internet”. Produkti i parë “Publikimi i fletores zyrtare” është realizuar plotësisht nga 230 fletore zyrtare të planifikuara janë realizuar 255, produkti i dytë “Botime Kode dhe Përmbledhëse Legjislacioni” janë planifikuar 12 dhe realizuar plotësisht. “Botimi i Buletinit të Njoftimeve Zyrtare” është planifikuar në 48 botime dhe është realizuar 45 botime, kurse “Publikimi në Internet” janë realizuar 312 nga 290 të planifikuara. Për Qendrën e Botimeve Zyrtare nuk janë parashikuar shpenzime kapitale per vitin 2017.


3. Programi “Instituti i Mjeksisë Ligjore”

Ky program, për vitin 2017, ka realizuar treguesit e shpenzimeve në **masën 95.26 %**, krahasuar me planin e periudhës, realizimi i zërave është si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 96.56 %
- Shpenzimet e tjera operative 91.75 %
- Shpenzimet kapitale 99.5 %

Gjithsej 95.26 %

Grafiku i paraqitur në mijë lekë



Realizimi i buxhetit është i realizuar pothuajse plotësisht, shpenzimeve të personelit dhe operative është në nivel shumë të mirë, kjo tregon për një punë të mirë të personelit të institucionit, fondet e akorduara janë përdorur në mënyrë eficiente duke përmbushur kështu objektivat e planifikuara.

Për vitin 2017, ky institucion ka parashikuar 7 produkte, Aktet e ekspertimit mjeko-ligjor (dokumenta çështje), aktet dëshmi-ligjore, aktet ekspertimi mjeko-ligjor (autopsi), aktet ekspertimi toksikologjiko-ligjor, aktet ekspertimi psikiatriko-ligjor, aktet ekspertimi biologjiko-ligjor, aktet ekspertimi histopatologjiko-ligjor dhe menaxhimi i punës në institut. Produktet janë realizuar pjesërisht. Kjo ndodh pasi është e pamundur që të ketë një parashikim fiks. Produkti i parë aktet e ekspertimit mjeko-ligjor (dokumenta çështje) nga 5.953 akte të planifikuara janë realizuar 2.325, gjithashtu aktet dëshmi-ligjore nga 4.694 të planifikuara janë realizuar 2.055, aktet ekspertimi mjeko-ligjor (autopsi) janë realizuar 750 nga 1.381 të planifikuara, aktet ekspertimi toksikologjiko-ligjor nga 2.818 të planifikuara janë realizuar 1.650 dhe aktet ekspertimi psikiatriko-ligjor janë realizuar pjesërisht sasia e planifikuar është 504 dhe janë realizuar 375, aktet biologjiko-ligjor janë realizuar 45 nga 130 të planifikuara, aktet histopatologjik ligjor, nga 790 të parashikuara janë realizuar 225 akte. Produkti i menaxhimit të institutit është realizuar plotësisht.


Shpenzimet kapitale janë realizuar plotësisht. Dy prej projekteve blerje pajisje zyre dhe dhe blerje pajisje për morgjet janë realizuar plotësisht sipas detajimit në buxhet. Gjithashtu dhe projekti për shtimin e katit të IML është hartuar dhe likuiduar. Projekti shtim kati nuk u realizua pasi u bllokuan të gjitha procedurat e prokurimit në bazë të VKM nr.482 datë 05.07.2017.

4. Programi “Sistemi i Burgjeve”

Realizimi i shpenzimeve të vitit 2017 për këtë program, që përfaqëson rreth 57.13 % të totalit të buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë, sipas zërave kryesore, krahasuar me planin e periudhës, rezulton si më poshtë:

• Shpenzimet e personelit	98.48%
• Shpenzimet e tjera operative	92.76 %
• Shpenzimet kapitale	93.85%
Gjithsej	96.7 %

Grafiku është në mijëra lekë



Duke iu referuar shifrave, shihet se realizimi i treguesve financiarë për periudhën është shumë i mirë, si në shpenzimet operative dhe në shpenzimet e personelit kanë patur një performancë shumë të mirë. Treguesit janë realizuar maksimalisht në terma sasiorë ashtu edhe në terma financiarë.

Për vitin 2017 janë parashikuar 14 produkte për aktivitetin kryesor të burgjeve si më poshtë:

1. Trajtimi me normë ushqimore i të dënuarve dhe paraburgosurve
2. Staf i trainuar nga qendra e trainimit
3. Të dënuar të trajtuar me shërbim shëndetësor
4. Trajtimi i të dënuarve të mitur në ambiente të përshtatshme të vuajtjes së dënimit
5. Trajtimi i të dënuarve femra me kushte të veçanta në ambientet e vuajtjes së dënimit
6. Mundësimi i programeve të reja të kualifikimit dhe punësimit për të dënuarit femra

7. Personel i punësuar femra në Sistemin e Burgjeve në funksion të trajtimit të të dënuarve
8. Mbajtja e të burgosurve dhe p/burgosurve në kushte sigurie nga trupa policore
9. Projekte të përfituara për Sistemin e Burgjeve
10. Rritja e kapaciteteve të I.E.V.P 313
11. Kosto lokale për ndërtimin Burgut Shkodër
12. Sistemi i informatizimit të kartelave të të dënuarve
13. Partneritet për projektin e binjakëzimit të të miturve IEVP Lezhë, për të miturit lezhë, ndërtimi i sheshit të ajrimit
14. Blerje pajisje sigurie për monitorimin për Sistemin e Burgjeve dhe pajisje logjistike
15. Blerje mjete transporti për Sistemin e Burgjeve

Disa nga këto produkte janë për të matur performancën e Sistemit të Burgjeve, kurse disa janë projekte për përmirësimin e kushteve në sistemin peniteciar. Këto produkte janë realizuar të gjithë plotësisht, sipas planifikimit produkti i parë është planifikuar 5.867 dhe është realizuar plotësisht, trajnimet janë kryer sipas planifikimit të fillim vitit kurse trajtimi me shërbim shëndetësor është sipas rasteve dhe në vazhdimësi për të sëmurët me sëmundje kronike. Për sa i përket të dënuarave të mitur është ulur numri i tyre në burgje sepse janë transferuar në institucionet e veçanta të vuajtjes së dënimit. Për të dënuarat femra janë krijuar kushte të veçanta të vuajtjes së dënimit, janë krijuar mundësi për pjesëmarrje në programe kualifikimi për të patur mundësi punësimi pas vuajtjes së dënimit.


Për sa i përket shpenzimeve kapitale ato janë realizuar në 93.85 %. Për studim projektimin është likuiduar vlera e prokuruar, për projektin furnizim vendosje të sistemit të kamerave për burgun Fushë-krujë është realizuar shumica e prokuruar. Kosto lokale është realizuar plotësisht sipas vlerës së prokuruar nga Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Gjithashtu dhe për projektet e tjera realizimi është sipas vlerave të prokuruar.

5. Programi “Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor”

Realizimi i shpenzimeve për vitin 2017, krahasuar me buxhetin e akorduar të periudhës, është në **masën 87%**. Realizimi i shpenzimeve sipas zërave kryesorë, rezulton si më poshtë:

- | | |
|--------------------------------|---------|
| • Shpenzimet e personelit | 93.37 % |
| • Shpenzimet e tjera operative | 86.67 % |
| • Shpenzimet kapitale | 22 % |

Gjithsej	75 %
-----------------	-------------



Treguesit buxhetorë tregojnë për një realizim të mirë të shpenzimeve të personelit, dhe të shpenzimeve operative. Për sa i përket shpenzimeve kapitale u lidh kontrata me firmat fituese të tenderit të kryer nga Ministria e Brendshme por nuk u realizuan pasi afati për dorëzimin e mallit tejkalonte vitin 2017.


Janë parashikuar 2 produkte për periudhën aktuale, “Ekzekutimi i titujve ekzekutivë”, dhe “Menaxhimi i Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor”. Gjatë kësaj periudhe, produkti i parë është realizuar pjesërisht janë ekzekutuar 7,664 tituj ekzekutivë, nga 12,884 të planifikuara për këtë vit. Produkti i dytë është realizuar plotësisht sipas parashikimit.

6. Programi “Shërbimi për Çështjet e Birësimeve”

Ky program, për vitin 2017, ka realizuar treguesit e buxhetit në **masën 90%**. Krahasuar me planin e periudhës, shpenzimet janë realizuar në zëra si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 85.76 %
- Shpenzimet e tjera operative 99%
- Shpenzimet kapitale 85%

Gjithsej 80 %



Realizimi i shpenzimeve të personelit dhe shpenzimeve operative është shumë i mirë madje shpenzimet operative janë realizuar maksimalisht.

Për vitin 2017, ky program ka parashikuar dy produkte “birësime të realizuara” dhe “blerje pajisje elektronike”, produkti i parë 45 të planifikuara për periudhën janë realizuar 43 birësime. Për mosrealizimin plotësisht të këtij produkti ka ndikuar ulja e numrit të dosjeve të fëmijëve të shpallur të braktisur me vendim gjykatë dhe të paraqitur pranë Komitetit Shqiptar të Birësimeve nga institucionet e përkujdesit social. Produkti i dytë është realizuar plotësisht diferenca e fondit të planifikuar me realizimin është kursim nga procedura e blerjes së vogël.

7. Programi “Agjencia e Trajtimit të Pronave”


Realizimi i shpenzimeve buxhetore vitit 2017, krahasuar me buxhetin e akorduar të periudhës, është në **masën 87.42 %**. Gjtaë vitit 2017 brenda programit të ATP është përfshirë dhe ALUIZNI. Realizimi i shpenzimeve të këtyre 2 institucioneve, sipas zërave kryesorë, rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 99.82 %
- Shpenzimet e tjera operative 84.73 %
- Shpenzimet kapitale 91.6 %

Gjithsej për shpenzimet buxhetore 87.42%

- Shpenzimet nga të ardhurat jashtë buxhetore 38.5 %

Grafiku i realizimit të shpenzimeve në mijëra lekë



Siç shihet nga shifrat, rezultatet e realizimit janë në nivele shumë të mira

Për vitin 2017, Agjensia e trajtimit të Pronave ka planifikuar 5 produkte, produkti i parë “kryerja e procesit të vlerësimit financiar të vendimeve përfundimtare nga viti 1993 e në vijim dhe shpërndarja e fondit vjetor të kompensimit” është realizuar 100% kurse produkti i dytë “trajtimi me vendim i kërkesave për kalimin në pronësi të oborreve në përdorim” nga 220 të planifikuar a janë realizuar 167 realizuar. Produkti i tretë është të mbrojë interesat e ATP në proceset gjyqësore nga 7.000 të planifikuara janë ndjekur 865 raste. Trajtimi i kërkesave ndër vite për njohje pronësie janë realizuar 50% ndërsa shpërndarja e fondit për kompensim financiar për pronarët e pasurive të paluajtshme që preken nga ndërtimet informale nga 800 të planifikuara janë realizuar 1.760.

Për sa i përket shpenzimeve kapitale ato janë detajuar në 7 projekte. Projekti rikonstruksioni i ambjenteve të ATP, blerje pajisje zyrash dhe blerje pajisje elektronike janë realizuar plotësisht. Vendosija e sistemit të monitorimit dhe sistemi telefonik VOIP nuk janë realizuar pasi miratimi nga AKSHI është marrë shumë vonë dhe nuk është bërë e mundur realizimi i procedurës së prokurimit.

Sistemi aksesi të hyrje daljeve të personelit dhe blerje kondicionerësh janë realizuar sipas vlerës së prokuruar.


Për sa i përket shpenzimeve kapitale të ALUIZNI-t, për vitin 2017, janë parashikuar “blerje pajisje zyrash” dhe “blerje pajisje elektronike” janë realizuar plotësisht sipas planifikimit.

8. Programi “Shërbimi i Provës”

Realizimi i shpenzimeve vitin 2017, krahasuar me buxhetin e periudhës, është në **masën 89.48%**, sipas zërave kryesorë, rezulton si më poshtë:

- Shpenzimet e personelit 90.7 %
- Shpenzimet e tjera operative 82 %


Gjithsej 89.48%



Për vitin 2017, Drejtoria e Shërbimit të Provës ka parashikuar 3 produkte: “persona të mbikqyrur”, “persona të mbikqyrur elektronikisht” dhe “femra të përfshira në programin e riintegritit”. Të tre produktet janë realizuar plotësisht nga ana sasiore, produkti i parë është parashikuar 4046 persona janë mbikqyrur plotësisht. Produkti i dytë dhe i tretë janë realizuar plotësisht 113 persona të mbikqyrur në mënyrë elektronike dhe 192 numri i femrave të riintegruara. Shpenzimet kapitale janë shkurtuar me Aktin Normativ nr.3 datë 06.11.2017.

Po ju paraqesim me poshtë në një grafik përmbljedhës realizimin e fondeve të Ministrisë së Drejtësisë sipas programeve.

Realizimi i fondeve Buxhetore sipas Programeve në mijëra lekë



SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

ELIRA KOKONA

Konceptoi: O. Bejte
Pranoi: A.Leka
Pranoi: M. Zisi
Miratoi: A. Lamce
3 kopje/ datë 28/02/2018